



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1572 Prot. 5

Tiranë, më 6/12/2013

Lënda: Rekomandim për “Librari Adrion”, Tiranë

REKOMANDIM

Nr 43 ,datë 06/12/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit ,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, “Librari Adrion”, Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale (nenet 5-9)
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe konfidencialiteti (nenet 27, 28)
- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21).

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Kontrolluesi “**Librari Adrioni**” është një agjensi shpërndarje shtypi dhe librash, e cila operon në Shqipëri që në vitin 1994. Adrion Ltd furnizon të gjithë hotelet kryesore, aeroportin ndërkombëtar dhe të gjitha pikat e shitjeve në qytetet kryesore si: Tirana, Durrësi, Elbasani, Saranda, Shkodra, Vlora dhe Korça, si dhe pika të tjera në të gjithë Shqipërinë. Libraria ndërkombëtare tek Pallati i Kulturës në qendër të Tiranës dhe dy dyqanet e aeroportit janë pjesë e Adrionit dhe nga ai furnizohen me shtyp dhe libra, të huaj dhe shqip, si dhe suvenire.

Gjithashtu mund të porositen libra nga klientët e interesuar.

Grupi i kontrollit administrativ konstaton se:

Për kategorinë “klientë” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale me anë të një formulari të quajtur “regjistrimi i kartës së klientit”. Këto të dhëna i merren klientit me pëlqimin e tij duke firmosur tek formulari manual, më pas pasi klienti ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim, ku në pikën e fundit të këtij formulari citohet se: “informacioni i lëshuar nga ju do të përdoret vetëm për qëllime statistikore”.

Me këtë kartë klienti ka të drejtë për një ulje të privilegjuar në blerjet që ai kryen pranë dyqaneve të Librari Adrion.

Në kartën e klientit kërkohen këto të dhëna nga kontrolluesi: Emër, mbiemër, datëlindja, vendlindja, seksi, gjinitë preferenciale për të lexuar, adresa, qyteti, rrethi, kutia postare, telefoni, e-mail.

CCTV

Ambienti i kontrolluesit monitorohet përmes një sistemi CCTV të përbërë nga katër kamera fikse. Qëllimi i vendosjes së këtij sistemi është siguria e ambienteve dhe identifikimi i përgjegjësve në rast incidentesh.

Është vendosur tabela informuese për monitorimin me këtë sistem, por kjo tabelë nuk është në përputhje me standartin e miratuar me Urdhërin nr. 33, dt. 27/06/2011 të Komisionerit.

Afati i ruajtjes së regjistrimeve në pajisjen regjistruese nuk e kalon periudhën 3 javore. Sistemi i kamerave nuk aksesohet apo mbikëqyret nga jashtë. Aksesimi është i kufizuar për punonjësin e turnit të kontrolluesit, i cili është personi përgjegjës që mund ti rikthehet në kohë regjistrimit në rast të një incidenti.

Gjithashtu u konstatua se kontrolluesi “Librari Adrion” nuk dispononte një rregullore të brendshme ku të parashikohet mënyra e mbledhjes, përpunimit, konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë “klientë” në zbatim të nenit 27 pika 2/1 dhe neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ku citohet shprehimisht se: *“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”*.

“Kontrolluesi, përpunuesi dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.....”.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi në faqen tuaj në internet nuk ka të publikuar “politikat e privatësisë”, që janë një paketë rregullash të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit. Këto politika ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi “Librari Adrion” nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të “nxënësve/studentëve”, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” .

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

- **Neni 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.

- **Neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi, përpunuesi dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.....”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Në faqen tuaj në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
3. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Me plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
Flora ÇABEL (POGAÇE)

